



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/78
Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 77 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/78

Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit të Buxhetit 03/L - 105, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shtesa në vlerë prej 200 Euro në muaj për periudhën gjashtë mujore 01.07.2009, deri më 31.12.2009, për 70 zyrtarë të Departamentit të Sekretariatit.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/78

Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Agjencinë për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritimit Evropian.
2. Ngarkohet Agjencia për Koordinimin e Zhvillimit dhe Integritimit Evropian për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/78

Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2009.
2. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2009 të rishikohet dhe harmonizohet me versionin e rishikuar të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2009-2012 dhe planifikimet buxhetore për të njëjtën periudhë.
3. Obligohen Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Koordinim të Zhvillimit dhe Integritet Evropian, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe ministritë/institucionet e tjera relevante për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/78

Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

1. Të hartohet Programi dhe Plani i Veprimit i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Parandalimin e Vetëvrasjeve dhe Vetëdëmtimit në Kosovë për periudhën 2010-2013.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë për hartimin dhe koordinimin e këtij procesi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/78
Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 34.20 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurim Publik të Ndryshuar me Ligjin Nr. 02/L-99, si dhe të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13.08.2009, mori:

V E N D I M

Për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 08/77 të datës 10.08.2009

1. Pika 1 e vendimit nr. 08/77, i datës 10.08.2009, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndryshohet me sa vijon:

“Blerja e objekteve bëhet në këto shtete pranuese, ku janë të akredituara ambasadat e Republikës së Kosovës: Uashington (SHBA), Londër (Mbretëri e Bashkuar), Bruksel (Belgjikë), Paris (Francë) dhe Berlin (Gjermani).”

2. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/78
Datë: 13.08.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 të Ligjit për Aviacionin Civil Nr. 03/L - 051, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 gusht 2009, mori

V E N D I M

Për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 04/71 të datës 03.07.2009

1. Pika 2 e vendimit nr. 04/71, i datës 03.07.2009, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndryshohet me sa vijon:

“Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.”

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë